



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan më ____, ____, 2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruktion i rrugës “Kryezjarr”, Njësia Administrative Shirgjan, Elbasan”, me fond limit 18,524,808 (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e tetë) **lekë pa t.v.sh.**

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Elbasan, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10, Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas shtojcës 7.

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi:Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situation përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes ne dorezim,- Faturat tatimore te deklaruar ne organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë
- **N.P - 4 A** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- **N.P – 5 A** Punime nëntokësore, ura e vepra arti
- **N.P – 7 A** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.
- **N.P – 12 A** Punime të inxhinierisë të mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- **N.S - 6 A** Sinjalistika rrugore jodriçuese
- **N.S – 18 A** Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojne nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates , ne plotesimin te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, 5ndu 23.12.2020 “Për prokurimin 5ndust”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, 5ndu 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit

dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të percaktuar kategoritë perkatese dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndertimit.

Kategoritë e licensave janë percaktuar në bazë të zerave të pershkruara në preventivin e projektit.

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime germimi në tokë	Punime germim dheu sipas preventivit: Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjeresi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet; Germim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir	A	0-20 milion
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Punimet e shtresave sipas preventivit për ndertimin e rrugës: Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese stabilizant t=10cm; Shtrese çakelli t=10cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	A	0-20 milion
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punimet për muret mbajtëse sipas preventivit: Mure buto betoni C 12/15; Struktura monolite betoni C 20/25	A	0-20 milion
NP-7	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Punimet për ujësjellës e kanalizim të jashtëm sipas preventivit: F.V. Tuba plastmasi Ø 80; F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm; Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm	A	0-20 milion
NP-12	Punime të inxhnierisë të mjedisit	Rruga ku do të kryhen punimet është rruga që ka fluksin më të madh të levizjes së automjeteve si dhe përgjatë saj shtrihen një bllok i madh parcelash të fermereve të zonës, pra është një rrugë, e cila shërben për të shkuar jo vetëm në banesat e banorëve të fshatit, por edhe në parcelat e tyre. Sa me sipër, duke qenë se punimet parashikojnë germim në të gjithë gjatësinë e rrugës, përdorim të mjeteve të renda, si edhe të materialeve si bitum, asfalt, çakel, beton etj, lind e	A	0-20 milion

		<i>nevojshme minimizimi i demeve ne mjedis, duke ndermarre masa mbojtese ose cdo mase te nevojshme per te minimizuar ose ndalur efektin negativ ne mjedisin perreth duke perfshire banesat apo te mbjellat.</i>		
NS-6	<i>Sinjalistika rrugore jodriçuese</i>	<i>Punimet per sinjalisten horizontale dhe vertikale te parashikuara ne preventiv: Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente; F.V. Tabela trekendore e vogel me A = 60; F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm</i>	A	0-20 milion
NS-18	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Punimet topogjeodezike sipas projektit topografik</i>	A	0-20 milion

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën dhe listpagesat e shoqërisë, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë.)

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Totograf 1 (një)
- Inxhinier Mjedis 1 (një)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. **Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqerise.**

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet apo veprimtaritë konkrete, të cilat lidhen edhe me kategoritë e licensave, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime ndërtimi, Rikonstruksioni, Germimi, Prishje), të cilave i korrespondojnë kategoritë NP-1, NP-4, NP-5.
1 (nje) Inxhinier Hidroteknik	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të Kanalizime, të cilave i korrespondon kategoria NP-7
1 (nje) Inxhinier Gjeodet	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit punime që përfshihen në kategorinë NS-18

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik, punonjës të kualifikuar dhe të thjeshtë, si mëposhtë:

- 1 (nje) punonjës teknik ndërtimi
- 1 (një) punonjës teknik topograf
- 1 (nje) hidraulik
- 2 (dy) karpentiere
- 2 (dy) betonues
- 4 (kater) punonjes asfaltimi ne rruge

- 3 (tre) shofere
 - 2 (dy) manovratore eskavatoriste
 - 2 (dy) manovratore buldozeriste
 - 1 (nje) manovrator automakinist
 - 5 (pese) punonjës të thjeshtë/ndihmes
- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.
 - Për punonjësit e kualifikuar të ndërtimit të paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH “ I ndryshuar.
 - Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.
 - ***Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.***
 - Ndërsa për punonjësit shofere dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten dëshmi të aftësive profesionale / leje drejtimi dhe certifikate të aftësimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.
 - **Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet e rënda në pronësi, duhet të ketë operatorët e mjeteve në listëpagesë për tre muajt e fundit.**
 - **Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin,** kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.**

Argumentimi: vendosja e këtij kriteri bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Në përcaktimin e profileve konkrete të stafit teknik punonjësve të kualifikuar, si dhe numrit të tyre, AK është bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar, Urdhërin nr.200, datë 16.05.2019 të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit“, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË

SHQIPËRISË“, i ndryshuar, zerat e punimeve te preventivit, volumet per keto zera dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic janë germimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muratures etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat per punetoret dhe ndjek ecurine e tyre gjate kohes se punes.
- **Tekniku topograf** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit ne ndertimet e reja qe do te kryhen duke asistuar drejtuesin teknik.
- **Hidrauliku** është i nevojshem për realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zerave te preventivit. Bejne piketimin dhe armaturen anesore te themelit, bejne vendosjen e modinave per kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojne skelerine perforcuese per fazen e betonimit te mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve betonues eshte parashikuar te realizohet ne muajin e pare dhe te dyte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te betonit sipa zerave te preventivit. Ndhmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve betonues eshte parashikuar te realizohet ne muajin e pare dhe te dyte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.
- **Punonjes asfaltimi ne rruge** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te asfaltit sipas zerave te preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve te asfaltimit eshte parashikuar te realizohet ne muajin e trete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.

- **Shoferi** është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina. Numri i kërkuar është bazuar në grafikun e punimeve, numrin e mjeteve të kërkuara sipas volumeve për transportin e dherave dhe materialeve të ndërtimit të dalë nga germimi dhe prishja, transportin e materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit.

- **Manovratori eskavatorist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si eskavator germimi dhe fadroma të të gjitha llojeve, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator germimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **ESKAVATORIST**.

- **Manovratori buldozerist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **grejder, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni**, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa b, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

b)- buldozer germimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, **rul vibrues, shtruese asfalto-betoni**, skreperët, **grejderët** dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj. **manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST**.

- **Manovratori automakinist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **autobitumatriçe, autobetoniere**, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, **autobetonierë**, autopompa betoni, **autobitumatriçe**, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **AUTOMAKINIST**.

2.3.6 Nje punësim mesatar për tre muajt e fundit, i të paktën **28** (njetzet e tete) personave të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipermdo të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës është bazuar në llogaritjen e orëve të punës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, grafikun e punime, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zëra. **Duke e bazuar në keto komponente AK përcaktoi stafin kryesor teknik (inxhinieret), një numër minimal punonjësish të kualifikuar për çdo lloj punimesh dhe një numër minimal punonjësish të thejshte/ndihmes. Nga ky numër rezultoi se për të perfunduar brenda afatit dhe me sukses zbatimin e kontratës operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë minimalisht një numër prej 28 punonjësish (stafi kryesor teknik + punonjës të kualifikuar + punonjës të thejshte/ndihmes).**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të certifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (I ndryshuar).

Për punonjësit e mesiperm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipermdo të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur për të bërë në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, neni 49, pika 4. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit gjykon se për mbarrëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin

e punimeve si dhe punonjesve te kualifikuar per punimet ne lartesi. Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet:
”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Ne nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

Në pikën 15 të V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, ndër të tjera parashikohet:

2.3.8 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” sipas kodeve 17 05 04 ose te kete kontrate sherbimi noteriale me shoqeri te pajisur me licensen e lartpermendur. *Licenca duhet të shoqerohet me akt miratimin.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar; Ligjin Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta” ; VKM 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”; ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

Referuar Preventivit te Punimeve dhe specifikimeve teknike, ku ndër të tjera është parashikuar kryerja e punimeve te prishjes, gjenerohen mbetje te klasifikimit 17 05 04 (Dhera dhe gure). Sa me siper, kriteri per disponimin e licences e leshuar nga QKL me kodin III. 2. B eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e mesiperme ose te kete kontrate sherbimi me subjekte te licencuara me licensen e lartepemendur, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”

Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, ose të kete kontrate shërbimi materiale me shoqëri të pajisur me licensën e lartpërmendur, ku të përfshihen ndër të tjera edhe **grumbullimi dhe transporti i mbetjeve që do të krijohen nga zërat e parashikuar të punimeve objekt prokurimi e në funksion të licencës.**

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 dhe 2 ku citohet se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor,

si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin

dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve/mjeteve	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 20 ton	Pronësi/Qira	copë	3
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton	Pronësi/Qira	copë	1
3	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Pronësi/Qira	cope	1
4	Eskavator me zinxhir me çekic	Pronësi/Qira	copë	1
5	Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	Pronësi/Qira	copë	1
6	Autobetoniere	Pronësi/Qira	copë	1
7	Asfaltoshtruese	Pronësi/Qira	copë	1
8	Autobitumatrice	Pronësi/Qira	copë	1
9	Autobot uji	Pronësi/Qira	copë	1
10	Rrul asfalti hekur–hekur me kapacitet 6 - 8 ton	Pronësi/Qira	copë	1
11	Rrul asfalti hekur–hekur me kapacitet 10 - 12 ton	Pronësi/Qira	copë	1

12	Rrul vibrues hekur–gome me kapacitet 4 -6 ton	Pronësi/Qira	copë	1
13	Rrul vibrues hekur–gome me kapacitet 8 -12 ton	Pronësi/Qira	copë	1
14	Grejder	Pronësi/Qira	copë	1
15	Makineri vijezi	Pronësi/Qira	copë	1
16	Vibrator betoni	Pronësi/Qira	copë	1
17	Vibrator thellesie	Pronësi/Qira	copë	1
18	Betoniere	Pronësi/Qira	copë	1
19	GPS/Total Station	Pronësi/Qira	copë	1
20	Linje inertesh	Pronësi/Qira/Kontr ate furnizimi	cope	1
21	Fabrike prodhim asfalti	Pronësi/Qira/Kontr ate furnizimi	cope	1

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si dhe certifikatë për transport mallrash (vetem mjetet e transportit), si dhe foto per secilin mjet te deklaruar ku te jete e dukshme dhe targa e mjetit.

Në rastin e mjeteve apo pajisjeve te tjera duhet te paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes, si dhe foto per secilin mjet te deklaruar.

Per mjetet e siguruara me qira, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qirase, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

b) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

c) Per linjen e prodhimit te inerteve, duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise/kontraten e qirase/kontraten e furnizimit. Ne rast se fabrika eshte ne pronesi/qira duhet te paraqitet edhe leja mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Ne rast se do te paraqitet kontrate furnizmi OE nuk detyrohet te paraqese lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B.

d) Per fabriken e asfaltit, duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise/kontraten e qirase/kontraten e furnizimit. Ne rast se fabrika eshte ne pronesi/qira duhet te paraqitet edhe leja mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Ne rast se do te paraqitet kontrate furnizmi OE nuk detyrohet te paraqese lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, 6/d dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike **makinerite, mjetet dhe paisjet teknike**. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive është bërë referuar zërave të punimeve reflektuar në tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
1	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet	copë 1
2	Eskavator me zinxhir me çekic	Germim shkëmbi mesatar me çekic me ekskavator me zinxhir kat 3	copë 1
3	Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	Eshtë kërkuar për shtytjen dhe largimin e dherave që krijohen nga germimet, sistemin e ambjentit.	copë 1
4	Automjet vetëshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 20 ton	Transport dheu me auto deri 5.0 km që do të kryhen gjatë muajit të parë sipas grafikut Jane gjithsej 1933 m ³ dhe’ të dala nga germimi me ekskavator me goma dhe ekskavator me zinxhir. Sipas llogaritjeve duhen 3 mjete 20 ton për të bërë transportin brenda afatit sipas grafikut. Gjithashtu këto mjete do të përdoren edhe për transport nenshtresa zhavori, cakell, stabilizant, binder, asfaltobeton	copë 3

5	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Per transoportin ne kantier te pajisjeve apo materialeve te punes gjate gjithë kohes se zbatimit te kontrates.	copë 1
6	Autobot uji	Per furnizimin me uje te kantierit per procese te ndryshme gjate punes	copë 1
7	Autobetoniere	Prodhim dhe transport betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit: Mure buto betoni C 12/15; Struktura monolite betoni C 20/25	copë 1
8	Asfaltoshtruese	Per punimet sipas preventivit: Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	copë 1
9	Autobitumatrice	Per punimet sipas preventivit: Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	copë 1
10	Grejder	Per punimet sipas preventivit: Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese stabilizant t=10cm; Shtrese çakelli t=10cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri	copë 1
11	Rrul hekur–hekur me kapacitet 6 - 8 ton	Per cilindrimin e asfaltit sipas preventivit: Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri. Fillimisht behet cilindrim me rul 6-8 ton para cilindrimit me rul me kapacitet 10-12 ton.	copë 1
12	Rrul hekur –hekur me kapacitet 10 -12 ton	Per cilindrimin e asfaltit sipas preventivit: Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri Pas cilindrimit me rul me kapacitet 6-8 ton behet cilindrimi me rul 10-12 ton.	copë 1
13	Rrul hekur–gome me kapacitet 4 -6 ton	Per cilindrimin e çakellit dhe stabilizantit sipas prventivit: Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese stabilizant t=10cm; Shtrese çakelli t=10cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri. Fillimisht behet cilindrimi paraprak, i cili realizohet nëpërmjet cilindrimit me rule 4-6 ton pa spërkatje periodike me ujë	copë 1
14	Rrul hekur–gome me kapacitet 8 -12 ton	Per cilindrimin e çakellit dhe stabilizantit sipas prventivit: Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese stabilizant t=10cm; Shtrese çakelli t=10cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri. Per ngjeshjen e plotë te çakullit, e cila realizohet nëpërmjet cilindrimit me rule 8-12 ton me spërkatje periodike me ujë	copë 1
15	Vibrator thellesie	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit: Struktura monolite betoni C 20/25	cope 1

16	Vibrator betoni	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit: Mure buto betoni C 12/15; Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm	cope 1
17	Makineri vijezi	Per punimet sipas preventivit: Vijezi shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm.	cope 1
18	Betoniere kantieri	Per prodhim llaçi per suvatim	cope 1
19	GPS/Total Station	Per punimet topogjeodezike sipas projektit	cope 1
20	Fabrike prodhim asfalti. Kerkesa eshte ne propocion me zerat e preventivit dhe me sasine e ketyre produkteve. Punimet e stresave jane nje nga zerat me te rendesishem te punimeve, si edhe duke qene nje nga zerat me sasine dhe vleren me te madhe financiare.	Per furnizim me asfaltobeton sipas preventivit.	cope 1
21	Linje prodhim inertesh. Kerkesa eshte ne propocion me zerat e preventivit dhe me sasine e ketyre produkteve. Punimet e stresave jane nje nga zerat me te rendesishem te punimeve, si edhe duke qene nje nga zerat me sasine dhe vleren me te madhe financiare.	Per furnizim me inerte sipas preventivit.	cope 1

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga drejtoria e projekteve, pjese perberese e strukture se Bashkise Elbasan, qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim;

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.